



Lajmet e Fundit:

Qarku Korçë – Vijon operacioni policor i koduar “Perimetri”. U kap duke transportuar 26 emigrantë të paligjshëm, me një mjet të cilin e drejtonte pa leje drejtimi, vihet në pranga 1 shtetas.



Lajmet

Njoftime

Operacionet

14/03/2021

Durrës – Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje. Finalizohet operacioni i koduar “Pranvera”.

Operacioni i zhvilluar nga Seksioni për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Forca e Posaçme Operacionale në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

Fshihej në lokalin e marë me qira, pasi ishte shpallur në kërkim, arrestohet në flagrancë 33-vjeçari i dënuar më parë për plagosje me armë zjarri dhe vjedhje të kryer në bashkëpunim.

Gjatë kontrollit në lokal iu gjetën dhe u sekuestruan 1 armë zjarri dhe municion luftarak.

Në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, kapjen e personave në kërkim dhe atyre që posedojnë armë zjarri, specialistët për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën Operacionale në DVP Durrës, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas i shpallur në kërkim fshihej në ambientet e lokalit që kishte marë me qira, në lagjen nr.14, Durrës, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Pranvera”, në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

G. P., 33 vjeç, banues në Durrës, i dënuar në vitin 2016 për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje” dhe “Armëmbajtja pa leje” dhe në vitin 2010 për veprën penale “Vjedhja e kryer në bashkëpunim”.

Shtetasi G. P. ishte shpallur në kërkim, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin i ka vendosur masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”.

Shërbimet e Policisë, pas marrjes së informacionit se ky shtetas fshihej në ambientet e lokalit që kishte marë me qira nga në lagjen nr. 14, Durrës, kanë shkuar menjëherë në adresën e dhënë, ku e kanë kapur dhe ndaluar shtetasin G. P.

Gjatë kontrollit në lokal u gjetën një armë zjarri pistoletë dhe 2 krehër me 15 fishekë, të cilët u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Tiranë- Finalizohet me sukses OPERACIONI POLICOR “PIRAMIDA”. Zbardhet vrasja e 66-vjeçarit, e ndodhur më 25 shkurt 2021.

Tiranë – Qarkullonte me armë zjarri me vete, falë bashkëpunimit me qytetarët, Forca e Posaçme “Shqiponjat” lokalizon dhe vë në pranga 20-vjeçarin. ▶